



**Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave  
Regulativni Autoritet Železnica  
Railway Regulatory Authority



Në bazë të nenit 38, paragrafi 2, neni 46 paragrafi 3 dhe 4, neni 104 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, Bordi i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave miraton këtë:

REPUBLIKA E KOSOVËS   REPUBLIKA KOSOVO   REPUBLIC OF KOSOVO	
AUTORITETI RREGULLATIV I HEKURUDHAVE	
REGULATIVNI AUTORITET ŽELEZNICA	
RAILWAY REGULATORY AUTHORITY	
DEP/SEK. DEP/SEK. DEP/SEK.	01
NR.PROT. BR.PROT. NR.PROT.	832
NUMRI I FAQEVE BROJ STRANA NR OF PAGES	19
DD.MM.VVVV. DD.MM.GGGG. DD.MM.YYYY.	22/12/2017
PRISHTINË / A	

**Rregullore Nr. 04/2017, për Metodat e Përbashkëta të Sigurisë për Vlerësimin e Konformitetit me kërkesat për marrjen e Autorizimit të Sigurisë hekurudhore**

Rr. Rustem Statovci nr.29  
Prishtinë, Kosovë  
Tel:+381 38 22 00 40  
Fax:+381 38 22 33 40  
Web:www.arh-ks.org

Kuvendi i Kosovës  
Skupština Kosova  
Assembly of Kosovo

## **Neni 1**

### **Qëllimi**

1. Kjo Rregullore përcakton një metodë të përbashkët të sigurisë (MPS) për vlerësimin e konformitetit me kërkesat për marrjen e autorizimit të sigurisë, siç përshkruhet në nenin 46 (3 dhe 4), nenin 104 (2) të Ligjit 04/L-063 për hekurudhat në Republikën e Kosovës si dhe nenin 6 (3) (b) dhe nenin 11 të Direktivës 2004/49 / EC. Kjo rregullore amandamenton Rregulloren e ARH-së me Nr. 03/2012, si dhe transponon rregulloren e BE-së me Nr. 1169/2010/EU.

MPS përfshinë:

1.1. procedurën dhe kriteret për vlerësimin e aplikacioneve të bëra nga menaxherët e infrastrukturës për marrjen e autorizimit të sigurisë, siç përmendet në Ligjin Nr. 04/L-063 neni 46 dhe 104, si dhe në nenin 11 (1) (a) dhe (b) të Direktivës 2004/49 / EC, siç përcaktohet në Shtojcën I dhe II të kësaj rregullore.

1.2. parimet për mbikëqyrjen e përputhjes me kërkesat e Direktivës 2004/49 / EC pasi që organi nacional i sigurisë ka dhënë autorizimin, siç përcaktohet në Shtojcën III të kësaj rregullore.

1.3. autorizimi i sigurisë autorizon operimin në infrastrukturën hekurudhore të përdorimit të përbashkët në Kosovë, vetëm nëse paraprakisht është dhënë licenca përkatëse.

## **Neni 2**

### **Fushëveprimi**

Dispozitat e kësaj rregullore zbatohen për të gjithë menaxherët e infrastrukturës hekurudhore të cilët operojnë ligjërisht brenda territorit të Republikë së Kosovës.

## **Neni 3**

### **Definicionet**

Për qëllimet e kësaj Rregullore, do të zbatohet përkufizimi i mëposhtëm:

"mbikëqyrja" nënkupton masat e aplikuara nga organi i sigurisë për të mbikëqyrur performancën e sigurisë, pasi që ky organ të ketë dhënë një autorizim të sigurisë.

## **Neni 4**

### **Formulari i aplikimi për autorizim të sigurisë**

Për të aplikuar për autorizim të sigurisë, aplikanti duhet të përdor formularin e aplikimit të ofruar nga ARH, ky formular mund të gjendet në faqen tonë të internetit [www.arh-ks.org](http://www.arh-ks.org).

Organi i sigurisë do ju njoftojë për pranimin e aplikacionit tuaj brenda 48 orëve nga momenti i protokollimit në ARH.

## **Neni 5**

### **Procedurat për vlerësimin e aplikacioneve**

5.1. Organi i Sigurisë duhet tu përgjigjet me përpikëri kërkesave dhe aplikimeve dhe të bënë komunikimin e informacionit sipas kërkesave të tyre pa ndonjë vonesë. Organi i Sigurisë duhet të miratoj të gjitha vendimet e veta brenda katër (4) muajsh pasi të pranohen të gjitha kërkesat, përfshirë informacionin plotësues.

5.2. Kur të shqyrtohen kërkesat për autorizim të sigurisë të paraqitura pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore, organi nacional i sigurisë do të zbatojë procedurën e përcaktuar në Shtojcën I të kësaj Rregullore për vlerësimin e konformitetit të tyre me kërkesat e Direktivës 2004/49 / EC. Organi nacional i sigurisë duhet të përdorë kriteret e vlerësimit të përcaktuara në Shtojcën II të kësaj Rregullore.

5.3. Gjatë vlerësimit, organi nacional i sigurisë mund të pranojë zotimin nga aplikantët se ata do të menaxhojnë rreziqet gjatë përdorimit të kontratave me palë të treta. Kontratat duhet të specifikojnë shkëmbimin e informatave të nevojshme për të siguruar funksionimin e sigurt të mjeteve lëvizëse, sidomos në zonat që lidhen me menaxhimin e mirëmbajtjes.

5.4. Produktet ose shërbimet e ofruara nga kontraktorët ose furnizuesit për menaxherët e infrastrukturës do të konsiderohet që janë në përputhje me kërkesat e sigurisë nëse kontraktorët, furnizuesit, ose produktet janë të certifikuara në përputhje me skemat përkatëse të certifikimit të përcaktuara në bazë të legjislacionit të Bashkimit Evropian, për ofrimin e produkteve dhe shërbimeve të tilla.

## **Neni 6**

### **Mbikëqyrja**

Pas dhënies së autorizimit të sigurisë, organi nacional i sigurisë do të mbikëqyrë menaxherët e infrastrukturës në zbatimin e vazhdueshëm të sistemit të tyre të menaxhimit të sigurisë (SMS) dhe duhet të zbatohen parimet për mbikëqyrje të përcaktuara në Shtojcën III të kësaj rregullore si dhe të rregullores së ARH-së Nr. 03/2013, për Metodën e Përgjithshme të Sigurisë për Mbikëqyrje nga Organi përgjegjës i sigurisë pas lëshimit të një certifikate apo autorizimi të sigurisë.

## **Neni 7**

### **Llojet e autorizimeve të sigurisë në Kosovë**

7. ARH-Organi i sigurisë lëshon këto lloje të autorizimeve të sigurisë për menaxherë të infrastrukturës hekurudhore në Kosovë:

7.1. Autorizimin e sigurisë për funksionimin/operimin e rrjeteve hekurudhore dhe infrastrukturës hekurudhore - A (autorizimi i sigurisë pjesa A dhe B).

7.2. Autorizimi i sigurisë për stacione hekurudhore, stacionet për formimin dhe shformimin e trenave (stacionet ranzhiruese) - B (autorizimi i sigurisë pjesa A dhe B).

7.3. Autorizimi i sigurisë për mirëmbajtjen e depove për mjetet lëvizëse hekurudhore dhe mjeteve tjera të mirëmbajtjes - C (autorizimi i sigurisë pjesa A dhe B).

7.4. Autorizimi i sigurisë për operacione të kombinuara të rrjetit hekurudhorë dhe infrastrukturës hekurudhore, stacione hekurudhore dhe stacione për formimin dhe shformimin e trenave, mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse hekurudhore - D (autorizimi i sigurisë pjesa A dhe B).

### **Neni 8**

#### **Autorizimi i sigurisë (pjesa A) i lëshuar nga vendet e tjera**

Autorizimi i sigurisë pjesa A i lëshuar nga një organ i sigurisë të Bashkimit Evropian (BE), do të jetë valid edhe në Kosovë nëse është në përputhje me legjislacionin e Kosovës.

Autorizimi i sigurisë pjesa A i lëshuar nga një organ i sigurisë të pjesëmarrësve të SEETO, nënshkrues të Marrëveshjes së Komunitetit të Transportit do të jetë valid në Kosovë nëse ka marrëveshje për njohje reciproke të autorizimit të sigurisë.

### **Neni 9**

#### **Konfidencialiteti**

Gjatë aplikimit për autorizim të sigurisë organi i sigurisë mund të pranoj dokumentacion i cili mund të jetë i ndjeshëm komercial. Në rast se aplikanti vlerëson se një pjesë e caktuar e aplikacionit përmban informata të ndjeshme komerciale, atëherë aplikanti duhet që këtë pjesë të aplikimit ta vulos si "Konfidencial". Nëse pjesë të caktuara të aplikacionit nuk vulosen si të tilla atëherë asnjë pjesë e dokumentacionit nuk do të konsiderohet si e ndjeshme komerciale.

### **Neni 10**

#### **Njoftimi**

ARH-organi i sigurisë do të njoftoj Ministrinë e Infrastrukturës kur të merret një vendim për dhënien e autorizimit të sigurisë.

### **Neni 11**

#### **Vlefshmëria e autorizimit të sigurisë**

Autorizimi i sigurisë i lëshuar nga organi i sigurisë ka vlefshmëri 5 vite.

**Neni 12**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

  
Arsim Berisha,  
Kryesues i Bordit  
Prishtinë: 22/12/2017

## SHTOJCA I

### **Procedura për vlerësimin e konformitetit me kërkesat për marrjen e autorizim të sigurisë të lëshuara në përputhje me nenin 46 (3 dhe 4), nenin 104 (2) të Ligjit 04/L-063 për hekurudhat në Republikën e Kosovës dhe nenin 11 (1) (a) dhe (b) të Direktivës 2004/49 / EC**

1. Procedurat që organi nacional i sigurisë ka aplikuar për të vlerësuar aplikimet për marrjen e autorizimit të sigurisë duhet të ndërtohen mbi parimet e mëposhtme.

#### (a) Ngritja dhe rishikimi i procesit të vlerësimit

Organi nacional i sigurisë do të zhvillojë procese të strukturuar dhe të auditueshme që do të ndërmerren prej personave kompetent. Organi nacional i sigurisë do të shqyrtojë aplikimet sipas kriterëve të vlerësimit për sistemin e menaxhimit të sigurisë të përcaktuara në Shtojcën II. Ky organ do të regjistrojë dhe do të arsyetojë të gjitha vendimet. Procesi i përgjithshëm i vlerësimit nga ana e Organit nacional të sigurisë periodikisht do të rishikohet me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm për të siguruar efikasitetin dhe efektivitetin e tij.

#### (b) Cilësia e procesit të vlerësimit

Organi nacional i sigurisë do të monitorojë cilësinë e performancës së tyre në fazat kryesore të shqyrtimit të kërkesave për autorizim të sigurisë.

#### (c) Fusha e vlerësimit

Vlerësimi duhet të jetë në nivelin e menaxhimit të sistemit dhe procesit. Kur gjatë shqyrtimit zbulohen mangësi, organi nacional i sigurisë mund të ushtrojë diskrecion dhe, në varësi të natyrës dhe seriozitetit të mos-përputhshmërisë, do të përshkruajë pikat që duhet të përmirësohen. Në fund të fundit, organi nacional i sigurisë do të ushtrojë fuqinë e tij për të refuzuar një kërkesë.

Vlerësimi duhet të jetë:

- në përshtatje me rreziqet, karakterin dhe shtrirjen e operacioneve të aplikantit;
- bazohet në vendimet dhe aftësinë e përgjithshme të menaxherit të infrastrukturës për të vepruar në mënyrë të sigurt, siç përshkruhet në sistemin e tij të menaxhimit të sigurisë.

#### d) Afatet kohore të vlerësimit

Organi i sigurisë duhet ta kryejë vlerësimin brenda kohës së kërkuar në neni 19 (3) të ligjit 04/L-063, nenin 12 i Direktivës 2004/49 / EC dhe nenin 12 i Direktivës 2016/798 / EC, duke siguruar që provat e pranuar nga aplikanti të shqyrtohen në mënyrë të mjaftueshme. Organi i sigurisë

duhet të informojë menaxherët e infrastrukturës për mangësitë e madha sa më parë që është e mundur respektivisht gjatë fazës së vlerësimit.

e) Vendimmarrja gjatë vlerësimit

Vendimi për të pranuar ose refuzuar një kërkesë për autorizim të sigurisë duhet të bazohet në provat e ofruara nga aplikanti dhe duhet shqyrtuar nëse ka ose nuk ka përputhje me kërkesat përkatëse.

2. Organi i sigurisë do të vlerësojë nëse përmbledhja e bashkangjitur e manualit të sistemit të menaxhimit të sigurisë lejon një vlerësim fillestar mbi cilësinë dhe përshtatshmërinë e sistemit të menaxhimit të sigurisë dhe do të vendosë se në cilat fusha ka nevojë që të ketë më shumë informata. Organi i sigurisë mundet që të kërkojë më shumë informata nëse e gjykon të arsyeshme dhe të nevojshme për të ndihmuar në vlerësimin e aplikacionit për autorizim të sigurisë.

3. Kur jepet një autorizim i sigurisë, duhet që të ketë përputhshmëri në mes të sistemit të menaxhimit të sigurisë së aplikuesit me kriteret e vlerësimit si dhe duhet të dokumentohet në lidhje me secilin kriter të vlerësimit.

4. Kur identifikon një pikë të dyshimit ose ndonjë mospërputhje të mundshme, organi i sigurisë duhet të jetë specifik dhe të ndihmojë aplikuesin të kuptojë nivelin e detajeve të pritshme në përgjigje. Për ta bërë këtë duhet që:

- a) ti referohet me saktësi kriterëve përkatëse dhe të sigurojë që aplikanti të ketë kuptuar qartë fushat e identifikuara të mospërputhjes;
- b) të identifikojë pjesën e rregulloreve, rregullave dhe standardeve përkatëse;
- c) të deklaroj pse nuk është plotësuar kriteri i vlerësimit;
- d) të bien dakord për angazhime të mëtejshme për informata dhe dëshmi mbështetëse që duhet të sigurohen, siç kërkohet nga niveli i detajeve të kriterëve dhe të specifikojë veprimin e kërkuar nga aplikanti për të korrigjuar mangësinë dhe afatin kohor për pajtueshmërinë;
- e) të përcaktojë fushat të cilat mund të jenë subjekt i shqyrtimit të mëtejshëm nëpërmjet mbikëqyrjes pas dhënies së autorizimit.

## SHTOJCA II

**Kriteret për vlerësimin e konformitetit me kërkesat për marrjen e autorizimit të sigurisë që lëshohet në përputhje me nenin 104 (2.1) dhe (2.2) të Ligjit 04/L-063 dhe Nenin 11 (1) (a) dhe (b) të Direktivës 2004/49 / EC**

### A. MASAT E KONTROLLIT TË RREZIKUT PËR TË GJITHA RREZIQUET NË LIDHJE ME AKTIVITETET E MENAXHIT TË INFRASTRUKTURËS

A.1. Ka procedura të vendosura për të identifikuar rreziqet që lidhen me operimet hekurudhore, duke përfshirë ato që dalin drejtpërdrejt nga aktivitetet e punës, hartimin e vendeve të punës ose ngarkesën e punës dhe aktivitetet e organizatave / personave të tjerë.

A.2. Ka procedura për të zhvilluar dhe vënë në funksion masat e kontrollit të rrezikut.

A.3. Ka procedura të vendosura për të monitoruar efektivitetin e angazhimeve për të kontrolluar rrezikun dhe për të zbatuar ndryshimet kur kërkohet.

A.4. Ka procedura të vendosura që lidhen me nevojën për të punuar së bashku me subjektet e tjera (siç janë: ndërmarrjet hekurudhore, prodhuesit, ofruesi i shërbimit të mirëmbajtjes, subjekti përgjegjës për mirëmbajtjen, mbajtësi i mjeteve hekurudhore, ofruesi i shërbimeve dhe entiteti i prokurimit), aty ku është e përshtatshme, për çështje të caktuara kanë ndarë pikëpamjet që ka gjasa të ndikojnë në vendosjen e masave adekuate të kontrollit të rrezikut në përputhje me nenin 103 (2) të Ligjit 04/L-063 dhe nenin 4 (3) të Direktivës 2004/49 / EC.

A.5. Ka procedura për dokumentimin dhe komunikimin e dakorduar me subjektet përkatëse, duke përfshirë identifikimin e roleve dhe përgjegjësive të secilës organizatë pjesëmarrëse dhe specifikimet për shkëmbimin e informacionit.

A.6. Ka procedura për të monitoruar efektivitetin e këtyre marrëveshjeve dhe për të zbatuar ndryshimet kur kërkohet.

### B. KONTROLLI I RREZIKUT LIDHUR ME OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË MIRËMBAJTJES DHE MATERIALEVE

B.1. Ka procedura që rrjedhin nga kërkesat e mirëmbajtjes / standardeve / proceseve nga të dhënat e sigurisë.

B.2. Ka procedura për të përshtatur intervalet e mirëmbajtjes sipas llojit dhe shkallës së shërbimit të kryer.

B.3. Ka procedura për të siguruar që përgjegjësia për mirëmbajtjen është e përcaktuar qartë për të identifikuar kompetencat e kërkuara për pozitat e mirëmbajtjes dhe për të caktuar nivelet e duhura të përgjegjësisë.

B.4. Ka procedura për të mbledhur informacione për mosfunksionimet dhe defektet që dalin nga puna e përditshme dhe për t'i raportuar ato tek ata që janë përgjegjës për mirëmbajtjen.

B.5. Ka procedura për identifikimin dhe raportimin e rreziqeve që rrjedhin nga defektet dhe mos konformitetet e ndërtimit ose keq funksionimet gjatë gjithë ciklit të jetës për palët e interesuara.

B.6. Ka procedura për të verifikuar dhe kontrolluar performancën dhe rezultatet e mirëmbajtjes për tu siguruar që ato të jenë në përputhje me standardet e korporatave.

#### C. KONTROLLI I RREZIKUT LIDHUR ME PËRDORIMIN E KONTRAKTUESVE DHE KONTROLLIMI I FURNIZUESVE

C.1. Ka procedura për të verifikuar kompetencën e kontraktorëve (përfshirë nënkontraktuesit) dhe furnizuesit.

C.2. Ka procedura për të verifikuar dhe kontrolluar performancën e sigurisë dhe rezultatet e të gjitha shërbimeve dhe produkteve të kontraktuara dhe furnizuara nga kontraktuesi ose furnizuesi për të siguruar që ato janë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në kontratë.

C.3. Përgjegjësitë dhe detyrat që lidhen me çështjet e sigurisë hekurudhore janë përcaktuar qartë, të njohura dhe të alokuara ndërmjet partnerëve kontraktues dhe ndërmjet të gjitha palëve të tjera të interesuara.

C.4. Ka procedura për të siguruar gjurmueshmërinë e dokumenteve dhe kontratave që kanë të bëjnë me sigurinë.

C.5. Ka procedura për të siguruar që detyrat e sigurisë, duke përfshirë shkëmbimin e informacionit të sigurisë, kryhen nga kontraktorët ose furnizuesi sipas kërkesave përkatëse të përcaktuara në kontratë.

#### D. RREZIQET QË RRJEDHEN NGA AKTIVITETET E PALËVE TJERA JASHTË SISTEMIT HEKURUDHOR

D.1. Ekzistojnë procedura për identifikimin e rreziqeve të mundshme nga palët jashtë sistemit hekurudhor aty ku është e përshtatshme dhe e arsyeshme.

D.2. Ka procedura për vendosjen e masave të kontrollit për të zbutur rreziqet e identifikuara nën D1 për sa i përket përgjegjësive të aplikuesit.

D.3. Ka procedura për të monitoruar efektivitetin e masave të identifikuara në D2 dhe për të zbatuar ndryshimet kur është e përshtatshme.

## E. DOKUMENTIMI I SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË SIGURISË

E.1. Ekziston një përshkrim i aktivitetit që e bën të qartë llojin, shkallën dhe rrezikun e operimit.

E.2. Ka një përshkrim të strukturës së sistemit të menaxhimit të sigurisë, duke përfshirë alokimin e roleve dhe përgjegjësi.

E.3. Ka një përshkrim të procedurave të sistemit të menaxhimit të sigurisë të kërkuara nga Neni 9 dhe Shtojcën III i Direktivës 2004/49 / EC, në përputhje me llojin dhe shtrirjen e shërbimeve të operuara.

E.4. Proceset dhe detyrat kritike të sigurisë që lidhen me llojin e aktivitetit / shërbimit janë të shënuara dhe janë përshkruar shkurtimisht.

## F. SHPËRNDARJA E PËRGJEGJËSIVE

F.1. Ka një përshkrim se si është siguruar koordinimi i aktiviteteve të sistemit të menaxhimit të sigurisë në të gjithë organizatën, bazuar në njohuritë e provuara dhe përgjegjësitë kryesore te nivelit të menaxhimit.

F.2. Ka procedura për të siguruar që personeli me përgjegjësi të deleguara brenda organizatës ka autoritetin, kompetencën dhe burimet e duhura për të përmbushur detyrat e tyre.

F.3. Fushat e përgjegjësisë të lidhura me sigurinë dhe shpërndarja e përgjegjësi ndaj disa funksioneve specifike që lidhen me to, së bashku me ndërveprimin e tyre, janë të përcaktuara qartë.

F.4. Ekziston një procedurë për të siguruar që detyrat e sigurisë janë përcaktuar qartë dhe janë deleguar personelit përgjegjës.

## G. SIGURIMI I KONTROLLIT NGA MENAXHMENTI NË NIVELE TË NDRYSHME

G.1. Ekziston një përshkrim se si janë caktuar përgjegjësitë për secilin proces që ka të bëjë me sigurinë në të gjithë organizatën.

G.2. Ekziston një procedurë për monitorimin e rregullt të performancës së detyrave të deleguara nga zinxhiri i menaxhimit të linjës që duhet të ndërhyjë nëse detyrat nuk janë duke u kryer siç duhet.

G.3. Ka procedura për të identifikuar dhe menaxhuar ndikimin e aktiviteteve të tjera të menaxhimit në sistemin e menaxhimit të sigurisë.

G.4. Ka procedura për të mbajtur përgjegjës për punën e tyre ata që kanë një rol në menaxhimin e sigurisë.

G.5. Ka procedura për caktimin e resurseve për të kryer detyrat që janë pjesë e sistemit për menaxhimin e sigurisë.

#### H. PËRFSHIRJA E STAFIT DHE PËRFAQËSUESIT E TYRE NË TË GJITHA NIVELET

H.1. Ka procedura të vendosura për të siguruar që stafi dhe përfaqësuesit e stafit janë përfaqësuar në mënyrë adekuate dhe të konsultohen në përcaktimin, propozimin, shqyrtimin dhe zhvillimin e aspekteve të sigurisë për procedurat operacionale në të cilat mund të përfshihet stafi.

H.2. Përfshirja e stafit dhe konsultimet janë aranzhuar dhe dokumentuar.

#### I. SIGURIMI I PËRMIRËSIMIT TË VAZHDUESHËM

Ka procedura të vendosura për të siguruar, kur është e arsyeshme dhe praktike, përmirësimi i vazhdueshëm i sistemit të menaxhimit të sigurisë, kjo duhet të përfshijë:

a) procedurat për rishikimet periodike të sistemit të menaxhimit të sigurisë, nëse shihet se është e nevojshme.

b) procedurat për përshkrimin e masave për monitorimin dhe analizimin e të dhënave relevante të sigurisë.

c) procedurat për të përshkruar se si janë korrigjuar mangësitë e identifikuara.

d) procedurat për përshkrimin e zbatimit të rregullave të reja të menaxhimit të sigurisë të bazuara në zhvillim dhe mësimet e nxjerra.

e) procedurat për të përshkruar se si janë përdorur gjetjet e auditimit të brendshëm për të sjellë përmirësime në sistemin e menaxhimit të sigurisë.

#### J. POLITIKA E SIGURISË MIRATUAR NGA KRYESHEFI EKZEKUTIV I ORGANIZATËS DHE I KOMUNIKUAR TE I GJITHË PERSONELI

Një dokument që përshkruan se politika e sigurisë së organizatës ekziston dhe është:

a) komunikuar dhe vënë në dispozicion të i gjithë stafit, p.sh. Nëpërmjet intranetit të organizatës.

b) e përshtatshme për llojin dhe shtrirjen e shërbimit.

c) miratuar nga kryeshefi ekzekutiv i organizatës.

K. QËLLIMET CILËSORE DHE SASIORE TË ORGANIZATËS PËR MIRËMBAJTJEN DHE PËRMIRËSIMIN E SIGURISË, SI DHE PLANET DHE PROCEDURAT PËR ARRITJEN E KËTYRE OBJEKTIVAVE

K.1. Ka procedura për të përcaktuar objektivat përkatëse të sigurisë në përputhje me kornizën ligjor dhe ekziston një dokument që tregon këto objektiva.

K.2. Ka procedura për të përcaktuar objektivat përkatëse të sigurisë në përputhje me llojin dhe shtrirjen e operimeve hekurudhore dhe rreziqet përkatëse.

K.3. Ka procedura për të vlerësuar rregullisht performancën e përgjithshme të sigurisë në lidhje me objektivat e sigurisë së kompanisë dhe organizatës.

K.4. Ka procedura për të monitoruar dhe shqyrtuar rregullisht aranzhimet operationale duke:

a) mbledhjen e të dhënave relevante të sigurisë nga të cilat nxirret performanca e sigurisë dhe për të vlerësuar përputhjen me objektivat.

b) interpretimin e të dhënave përkatëse dhe zbatimin e ndryshimeve të nevojshme.

K.5. Ekzistojnë procedura të vendosura nga menaxheri i infrastrukturës për të zhvilluar plane dhe procedura për arritjen e objektivave të saj.

L. PROCEDURAT PËR TE PËRMBUSH STANDARDET EKZISTUESE TEKNIKE TË, REJA, NDRYSHUARA DHE OPERACIONALE OSE KUSHTE TË TJERA PARASHKRUARA

L.1. Për kërkesat e sigurisë që lidhen me llojin dhe shtrirjen e operimeve, ekzistojnë procedurat për:

a) identifikimin e këtyre kërkesave dhe azhurnimin e procedurave përkatëse për të pasqyruar ndryshimet e bëra ne to (ndryshojnë menaxhimin e kontrollit).

b) zbatimin e tyre.

c) monitorimin e pajtueshmërisë me kërkesat e sigurisë.

d) ndërmarrjen e veprimeve kur identifikohet mos përputhja.

L.2. Ka procedura të futura ne funksion për të siguruar që personeli i duhur, procedurat, dokumentet specifike, pajisjet dhe mjetet lëvizëse të përdoren për qëllimin e synuar.

L.3. Sistemi i menaxhimit të sigurisë ka procedura të futura ne funksion për të siguruar që mirëmbajtja të kryhet sipas kërkesave përkatëse.

M. PROCEDURAT DHE METODAT PËR TU KUJDESUR PËR VLERËSIMIN E RREZIKUT DHE MASAT ZBATUESE PER KONTROLLIN E RREZIKUT KUR NDRYSHOJNË KUSHTET OPERATIVE, MATERIALEVE TË REJA OSE NDAJ RREZIQEVE TË REJA PËR INFRASTRUKTUREN OSE GJATË OPERIMIT

M.1. Ekzistojnë procedura të menaxhimit të ndryshimeve në pajisje, procedura, organizim, staf ose ndërlidhje.

M.2. Ekzistojnë procedura të vlerësimit të rrezikut, për të menaxhuar ndryshimet dhe për të aplikuar Metodën e Përbashkëta të Sigurisë për vlerësimin dhe llogaritjen e rrezikut siç referohet në Rregulloren Nr. 352/2009/KE dhe Rregulloren Nr. 402/2013/KE kur kërkohet.

M.3. Ka procedura të vendosura për të plotësuar rezultatet e vlerësimit të rrezikut në procese të tjera brenda organizatës dhe t'i bëjnë ato të dukshme për personelin përkatës.

N. SIGURIMI I PROGRAMEVE DHE SISTEMEVE TË TRAJNIMIT TË STAFIT PËR TË SIGURUAR QË KOMPETENCA E STAFIT MBROHET DHE DETYRAT KRYHEN SIPAS PARASHIKIMIT

N.1. Ekziston një sistem i menaxhimit të kompetencës që përfshin së paku:

- a) identifikimin e njohurive dhe shkathtësive që kërkohen për detyrat që kanë të bëjnë me sigurinë.
- b) parimet e përzgjedhjes (niveli arsimor bazë, aftësia mendore dhe aftësia fizike e kërkuar).
- c) trajnimin fillestar dhe certifikimin e kompetencave dhe aftësive të fituara.
- d) trajnimin e vazhdueshëm dhe azhurnimin periodik të njohurive dhe shkathtësive ekzistuese.
- e) kontrollet periodike të kompetencave kur është e nevojshme.
- f) masa të posaçme në rast të aksidenteve / incidenteve ose mungesë të gjatë në punë, sipas kërkesës / kur është e nevojshme.
- g) trajnim specifik i sistemit të menaxhimit të sigurisë për stafin e përfshirë drejtpërsëdrejti në sigurimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit të sigurisë.

N.2. Ekzistojnë procedura brenda sistemit të menaxhimit të kompetencës që parashikohet për:

- a) identifikimin e pozitave që kryejnë detyra të sigurisë.

b) identifikimin e pozitive që përfshijnë përgjegjësitë për marrjen e vendimeve operacionale brenda sistemit të menaxhimit të sigurisë.

c) personeli të ketë njohuritë, shkathtësitë dhe aftësitë e nevojshme (mjekësore dhe psikologjike) të përshtatshme për detyrat e tyre dhe periodikisht t'i nënshtrohen ri-trajnimit.

d) alokimin e personelit me kompetencën e duhur për detyrat përkatëse.

e) monitorimin e kryerjes së detyrave dhe zbatimin e masave korrigjuese aty ku kërkohet.

## O. MASAT PËR OFRIMIN E INFORMACIONIT TE MJAFTUESHËM BRENDË ORGANIZATËS DHE KUR ËSHTE E PËRSHTATSHME NDËRMJET ORGANIZATAVE QË OPEROJNË NË INFRASTRUKTURËN E NJËJTË

O.1. Ka procedura për të siguruar që.

a) personeli ka njohuri dhe kupton sistemi për menaxhimin e sigurisë dhe informacioni është lehtësisht i arritshëm. dhe

b) dokumentacioni i nevojshëm që ka të bëjë me sistemin e menaxhimit të sigurisë i jepet personelit përkatës të sigurisë.

O.2. Ka procedura për të siguruar që.

a) informacioni kryesor operacional është i përshtatshëm dhe i vlefshëm.

b) stafi është i vetëdijshëm për ekzistencën e tij para se të zbatohet.

c) është në dispozicion të stafit dhe aty u është dhënë kopja e kërkuar.

O.3. Ekzistojnë marrëveshje për ndarjen e informacionit midis menaxherit të infrastrukturës dhe ndërmarrjeve të tjera hekurudhore.

## P. PROCEDURAT DHE FORMATI I DOKUMENTIMIT TË INFORMATAVE TË SIGURISË, PËRGATITJA E PROCEDURAVE PËR DIZAJNIM TË KONTROLLIT TË INFORMATAVE VITALE TË SIGURISË

P.1. Ka procedura për të siguruar që të gjitha informatat përkatëse të sigurisë janë të sakta, të plota, të qëndrueshme, të kuptueshme, të azhuruara në mënyrë të duhur dhe të dokumentuara siç duhet.

P.2. Ka procedura për:

a) formatizon, gjeneron, shpërndan dhe menaxhon kontrollin e ndryshimeve në të gjithë dokumentacionin përkatës të sigurisë.

b) të marrë, mbledhë dhe ruajtur të gjithë dokumentacionin / informacionin përkatës në letër ose në sisteme të tjera të regjistrimit.

P.3. Ekziston një procedurë për kontrollin e konfigurimit të informacionit vital të sigurisë.



Q. PROCEDURAT PËR TË SIGURUAR SE AKSIDENTET, INCIDENTET DHE NGJARJET E TJERA TË RREZIKSHME JANË RAPORTUAR, HULUMTUAR DHE ANALIZUAR SI DHE JANË MARRË PASAT PARANDALUESE

Q.1. Ka procedura për të siguruar që aksidentet, incidentet dhe ngjarjet e tjera të rrezikshme:

a) raportohen, regjistrohen, hulumtohen dhe analizohen,

b) raportohen, sipas kërkesave të legjislacionit përkatës te organet kombëtare.

Q.2. Ka procedura për të siguruar që:

a) rekomandimet nga organi nacional i sigurisë, organi për hetimin e aksidenteve nga industria / hetimet e brendshme janë vlerësuar dhe nëse janë të përshtatshme implementohen.

b) raportet përkatëse / informatat nga ndërmarrjet e tjera hekurudhore, menaxherët e infrastrukturës, subjektet përgjegjëse për mirëmbajtje dhe mbajtësit e mjeteve hekurudhore merren parasysh.

Q.3. Ekzistojnë procedura për përdorimin e informatat e rëndësishme që kanë lidhje me hetimin dhe shkaqet e aksidenteve, incidenteve, goditjeve të afërta dhe ngjarjeve të tjera të rrezikshme. Këto informata duhet të përdoren për të mësuar dhe kur ka nevojë të miratohen edhe masa parandaluese.

R. OFRIMI I PLANEVE PËR VEPRIM DHE ALARM DHE INFORMACION NË RAST TË EMERGJENCËS, I MIRATUAR ME AUTORITETET E DUHURA PUBLIKE

R.1. Një dokument që identifikon të gjitha llojet e emergjencave, duke përfshirë dështimin e operimeve si dhe ekzistojnë procedura për identifikimin e atyre të reja.

R.2. Ka procedura të vendosura për të siguruar identifikimin e çdo lloj të emergjencës:

a) shërbimet e emergjencës mund të kontaktohen menjëherë.

b) shërbimeve emergjente tu ofrohen paraprakisht të gjitha informatat përkatëse, për të përgatitur përgjigjen në rast të një emergjence.

R.3. Janë identifikuar rolet dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve dhe përcaktuar në një dokument.

R.4. Ekzistojnë plane për veprim, alarm dhe informacione dhe përfshijnë:

a) procedurat për të njoftuar të gjithë stafin përgjegjës për menaxhimin e emergjencave.

b) masat për t'i komunikuar këto me të gjitha palët, duke përfshirë udhëzimet emergjente për udhëtarët.

c) masat për kontaktimin e stafit kompetent menjëherë, në mënyrë që ata të mund të marrin çfarëdo vendimi të kërkuar.

R.5. Ekziston një dokument që përshkruan se si janë ndarë burimet dhe mjetet dhe si janë identifikuar kërkesat e trajnimit.

R.6. Ka procedura të vendosura për të rivendosur kushtet normale të funksionimit sa më shpejt të jetë e mundur.

R.7. Ka procedura për testimin e planeve emergjente në bashkëpunim me palët e tjera për të trajnuar personelin, procedurat e testimit, identifikimin e pikave të dobëta dhe verifikimin se si te menaxhohen situata të mundshme emergjente.

R.8. Ka procedura të vendosura për koordinimin e planeve emergjente me ndërmarrjet hekurudhore që operojnë në infrastrukturën e kompanisë dhe në çdo infrastrukturë tjetër me të cilën ka një ndërlidhje.

R.9. Ka marrëveshje për të ndaluar operimet dhe trafikun hekurudhor menjëherë, nëse është e nevojshme, dhe për të informuar të gjitha palët e interesuara për veprimet e ndërmarra.

#### S. DISPOZITAT PËR AUDITIMIN E BRENDSHËM PERIODIK TË SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË SIGURISË

S.1. Ekziston një sistem i auditimit të brendshëm i cili është i pavarur dhe i paanshëm dhe që vepron në mënyrë transparente.

S.2. Ka një planifikim të auditimeve të brendshme të planifikuara të cilat mund të rishikohen në varësi të rezultateve të auditimeve të mëparshme dhe monitorimit të performancës.

S.3. Ka procedura të aprovuara për të identifikuar dhe zgjedhur auditorët e duhur dhe kompetentë.

S.4. Janë vendosur procedurat për:

a) analizimin dhe vlerëson rezultatet e auditimeve.

b) të rekomanduar masat përcjellëse.

c) të përcjellur efektivitetin e masave.

d) të dokumentuar ekzekutimin e auditimeve dhe rezultatet e auditimeve.

S.5. Ka procedura për të siguruar që nivelet e larta të zinxhirit menaxhues janë të vetëdijshme për rezultatet e auditimeve dhe marrin përgjegjësinë e përgjithshme për zbatimin e ndryshimeve në sistemin e menaxhimit të sigurisë.

S.6. Ekziston një dokument që tregon se si janë planifikuar auditimet në lidhje me rregullimet e zakonshme të monitorimit për të siguruar përputhjen me procedurat dhe standardet e brendshme.

#### T. DIZAJNI I SIGURT I INFRASTRUKTURËS HEKURUDHORET

T.1. Ka procedura për të siguruar dizajnimin e sigurt të infrastrukturës gjatë gjithë ciklit jetësor të infrastrukturës, duke mbuluar projektimin dhe instalimin.

T.2. Ka procedura të cilat marrin parasysh ndryshimet teknike të infrastrukturës dhe menaxhimin e atij ndryshimi.

T.3. Ekzistojnë procedura që tregojnë se rregullat relevante që mbulojnë dizajnin e infrastrukturës dhe identifikon metodat kombëtare të sigurisë dhe se aplikanti pajtohet me to.

#### U. OPERIMI I SIGURT I INFRASTRUKTURËS

U.1. Ka procedura për të siguruar që infrastruktura menaxhohet dhe operohet në të një mënyrë të sigurt, duke marrë parasysh numrin, llojin dhe shtrirjen e operatorëve që operojnë në rrjet duke përfshirë të gjitha ndërveprimet e nevojshme në varësi të kompleksitetit të operimit.

U.2. Ka procedura që tregojnë se si menaxhohet siguria në kufijtë fizikë dhe operativ të infrastrukturës.

U.3. Ekzistojnë procedura që tregojnë se si efikas është menaxhimi i bashkëpunimit dhe koordinimit, në situata normale dhe në situata emergjente.

U.4. Ka procedura që tregojnë se rregullat që mbulojnë funksionimin dhe menaxhimin e sigurt të infrastrukturës / ndërlydhjeve të mjeteve lëvizëse janë identifikuar dhe se aplikanti pajtohet me to.

#### V. DISPOZITAT E MIRËMBAJTJES DHE MATERIALET

V.1. Ka procedura për të siguruar që mirëmbajtja e infrastrukturës kryhet në mënyrë të sigurt, duke përfshirë kontrollin e qartë të menaxhimit dhe dokumentimin e auditimit dhe inspektimit.

V.2. Ka procedura që sigurojnë që mirëmbajtja e infrastrukturës i plotëson nevojat specifike të rrjetit.

V.3. Ka procedura që tregojnë se rregullat që mbulojnë ofrimin e mirëmbajtjes dhe materialit janë identifikuar dhe se aplikanti pajtohet me to.

#### W. MIRËMBAJTJA DHE FUNKSIONIMI I SISTEMIT TË KONTROLLIT TË TRAFIKUT DHE SINJALIMIT

W.1. Ekzistojnë procedura për të siguruar që sistemi i kontrollit të trafikut dhe sinjalizimit funksionon dhe mirëmbahet në atë mënyrë që të sigurohet funksionimi i sigurt i hekurudhës.

W.2. Ka procedura për të përmbushur standardet ekzistuese, të reja dhe të ndryshuara teknike dhe operacionale.

W.3. Ekzistojnë procedura që përcaktojnë se si menaxhohet siguria fizikë dhe / ose operative e sistemit të kontrollit dhe sinjalizimit të trafikut, duke përfshirë mënyrën e menaxhimit të bashkëpunimit, nëse është e nevojshme.

W.4. Ekzistojnë procedura që tregojnë se janë identifikuar rregulla që mbulojnë funksionimin dhe mirëmbajtjen e sigurt të sistemit të kontrollit të trafikut dhe sinjalizimit dhe se aplikanti pajtohet me to.

### SHTOJCA III

#### Parimet e mbikëqyrjes pas dhënies së një autorizimi të sigurisë

1. Qasja e organit kombëtar të sigurisë për mbikëqyrjen e pajtueshmërisë, siç referohet në nenet 18 (3) dhe 100 (1) të Ligjit 04/L-063 dhe nenet 4 (1) dhe 16 (2) (e) të Direktivës 2004/49 / EC, do të bazohet në parimet e mëposhtme. Këto parime zbatohen në kuadrin e aktiviteteve të mbikëqyrjes në tërësi dhe në rastet individuale brenda asaj kornize.
2. Organi kombëtar i sigurisë zbaton parimin e proporcionalitetit ndërmjet zbatimit dhe rrezikut. Veprimi i ndërmarrë nga organi kombëtar i sigurisë për të arritur pajtueshmërinë ose për të kërkuar llogari nga menaxherët e infrastrukturës për mos përmbushjen e detyrimeve të tyre ligjore duhet të jetë proporcionale me çdo rrezik për sigurinë ose me seriozitetin e mundshëm të çdo mospërputhjeje, duke përfshirë ndonjë dëm real ose potencial.
3. Organi i sigurisë duhet të zbatojë parimin e qëndrueshmërisë së qasjes për të siguruar një qasje të ngjashme në rrethana të ngjashme për të arritur qëllime të ngjashme.
4. Veprimtaria mbikëqyrëse e organit kombëtar të sigurisë do të synojë në radhë të parë në ato aktivitete që organi kombëtar i sigurisë beson se krijojnë rreziqe më serioze ose kur rreziqet nuk janë të kontrolluara mirë. Për ta bërë këtë, organi kombëtar i sigurisë duhet të ketë metoda dhe fuqi për të vlerësuar performancën e përditshme të sigurisë të menaxherit të infrastrukturës.
5. Organi kombëtar i sigurisë vendos për prioritetet për përdorimin e burimeve të veta në mënyrë efektive. Veprimi do të përqendrohet tek ata që janë përgjegjës për rrezikun dhe që janë më të mirë për ta kontrolluar atë.
6. Organi kombëtar i sigurisë zbaton parimin e transparencës për të ndihmuar menaxherët e infrastrukturës që të kuptojnë se çfarë pritet prej tyre (duke përfshirë atë që ata duhet ose nuk duhet të bëjnë) dhe çfarë duhet të presin nga organi kombëtar i sigurisë.
7. Organi kombëtar i sigurisë është përgjegjës për vendimet e tij në përputhje me nenin 19 (7) të Ligjit 04/L-063, nenin 17 (3) të Direktivës 2004/49 / EC. Organi kombëtar i sigurisë duhet të ketë parime të cilat mund të vlerësohen. Për më tepër, ndaj organit kombëtar të sigurisë ka gjithashtu një procedurë ankimi.
8. Organi kombëtar i sigurisë duhet të zhvillojë marrëveshje bashkëpunimi me organet tjera të sigurisë për të ndarë informacionin me njëri-tjetrin dhe për të bashkërenduar përgjigjen e tyre ndaj çdo shkelje të sigurisë. Përveç kësaj, organi kombëtar i sigurisë do të zhvillojë marrëveshje bashkëpunimi me autoritetet e tjera kompetente në mënyrë që të ndajnë informacion dhe të zhvillojnë qasje të unifikuar për çështjet që ndikojnë në sigurinë hekurudhore.